

**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
BASALT PRIME  
SHPK**

Sot më datë 01 tetor 2024, në Tiranë, u paraqiten personalisht:

- Maksim Sallabanda, shtetas Shqiptar, pajisur me Pasaportë Nr. BF4112914 lindur më 21.02.1951 në Tiranë, banues në Rruga Kavajes; Njësia Administrative Nr. 10; 1001; Tiranë, ortak me përgjegjësi të kufizuar.
- Zana Gramshi, shtetase Shqiptare, pajisur me Pasaportë Nr. BA5426086 lindur më 04.03.1959 në Tiranë, banues në adresën rruga Vllazen Huta, Pallati 6, Shkalla 1, Ap. 56, Tiranë, ortak.

**I CILI NË CILËSINË E ORTAKËVE TE SHOQËRISË "BASALT PRIME" SHPK, VENDOSI TË  
MIRATOJË KËTË AKT THEMELIMI DHE STATUT.**

**TITULLI I**

**EMRI I SHOQËRISË – REGJIMI JURIDIK – SELIA – KOHËZGJATJA**

**NENI 1 – EMRI I SHOQËRISË**

1.1 në përputhje me legjislacionin shqiptar, është krijuar Shoqëria BASALT PRIME shpk, në vijim referuar si "Shoqëria".

1.2 Shoqëria ka logon dhe vulën e vet zyrtare.

**NENI 2**

2.1 "BASALT PRIME" shpk, është një Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

2.2 Aktiviteti i saj është i organizuar sipas dispozitave të Aktit të Themelimit, Statutit dhe dispozitave ligjore në fuqi, mbi Shfrytëzimin e mineraleve, shfrytëzimin e bazalteve në veçanti me punime në qiell të hapur, pra me karriera apo punime të tjera minerare, ngritjen e impianteve të përpunimit të këtyre mineraleve, eksport si lëndë inerte, si dhe ngritjen e linjave të veçanta për prodhimin e fibrës së bazaltit me përdorim të furrave të shkrirjes, prodhimin e produkteve me bazë fibrën e bazaltit, ambalazhimin dhe eksportin e tyre, si dhe të gjitha aktivitetet e tjera që janë në përputhje të plotë me legjislacionin civil në Republikën e Shqipërisë.


2.3 Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, Shoqëria mund të ndryshojë rejgimin e saj juridik, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe dispozitat e Statutit të saj.

2.4 Shoqëria fiton personalitet juridik nga data e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar.

**NENI 3**

3.1 Shoqëria ka selinë e saj në adresën: Rruga e Kavajes, Njesia Bashkiake Nr 10, Pallati 3, Shkalla 4, Ap.23, Tirane, Shqipëri.

3.2 Shoqëria mund të hapë ose të mbyllë degë, filiale dhe ose zyra përfaqësimi brenda Shqipërisë dhe/ ose jashtë vendit, ose të krijojë shoqëri të tjera me Partnere apo Aksionare pjesëmarrës.



#### **NENI 4 – KOHËZGJATJA**

4.1 Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë është e pakufizuar dhe fillon me regjistrimin e Shoqërisë në Regjistrin Tregtar. Ortakët e Shoqërisë mund të vendosin të kufizojnë kohëzgjatjen e aktivitetit me një vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

### **TITULLI II OBJEKTI**

#### **NENI 5 – OBJEKTI**

5.1 Objekti kryesor i Shoqërisë do të përfshijë, por nuk do të kufizohet vetëm në veprimtaritë e mëposhtme:

Shfrytëzimi i mineraleve, shfrytëzimi i bazalteve në veçanti, ndërtimi i impianteve për përpunimin e tyre, ndërtimi i impianteve për shkrirjen e bazaltit, prodhimi i produkteve me bazë fibër bazalti, ambalazhimi dhe eksporti i tyre.

Për më tepër Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër i cili nuk është i ndaluar nga ligji në fuqi, që sjell përfitime dhe është në interes të Shoqërisë.

### **TITULLI III**

#### **KAPITALI I SHOQËRISË- TRANSFERIMI I KUOTAVE-ZMADHIMI I KAPITALIT**

#### **NENI 6- Kapitali i Shoqërisë**

6.1 Kapitali i shoqërisë është në vlerën 10 000 lekë (dhjete mijë) Lekë.

Kapitali i shoqërisë është paguar plotësisht nga ortakët themelues si vijon:

- a- Maksim Sallabanda , nënshkruesi 1 (një) kuote e barabartë me 95% të kapitalit të shoqërisë me një vlerë prej lek 9 500 (nëntë mijë e pesëqind);
- b- Zana Gramshi , nënshkruesi 1 (një) kuote e barabartë me 5% të kapitalit të shoqërisë me një vlerë prej lek 500 (pesëqint);

6.2 Përgjegjësia e Ortakëve ndaj palëve të treta për detyrimet e marra përsipër nga Kompania është e kufizuar sipas pjesëmarrjes së ortakut në kapitalin e shoqërisë.

#### **NENI 7**

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit.

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, dhe në shërbime, nëpërmjet emërimit të një eksperti të autorizuar për këto contribute në natyrë.

Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zvogëlohet me vendim të Ortakëve në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.



Vendimi për zvogëlimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare të regjistrimit për regjistrim nga administrator, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

#### **NENI 8**

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) Kontributit në kapitalin e shoqërisë





- b) Shitblerjes
- c) Trashëgimisë
- d) Dhurimit
- e) Çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të tij në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723 datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të trashferueshme me rrugë trashëgimie.

#### TITULLI IV ORGANET VENDIMARRËSE DHE DREJTUESE

##### NENI 9

Organi vendimmarrës

Asambleja e ortakëve, është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e ortakëve, është organi vendimmarrës i Shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Çdo ndryshim statute duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.


Asambleja e ortakëve, vendos për çështje si:

- a) Përcaktimi i politikave tregtare të Shoqërisë
- b) Emërtimin dhe shkarkimin e administratorëve .
- c) Emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar
- d) Përcaktimin e shpërblimeve
- e) Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë
- f) Përfaqësimin e Shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve.
- g) Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë

Të gjitha vendimet e marra nga ortakët regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë.
- b) Shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve.
- c) Investime.
- d) Vendimet për riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundërshtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.



## NENI 10

### Administrimi

Administrator i Shoqërisë do të jetë Z. Maksim Sallabanda.

Administrator i Shoqërisë do të ushtrojë kompetencat e administrimit për një afat 5 vjeçar me të drejtë ripërtëritje.

Administrator emërtohet dhe shkarkohet me vendim të Asamblesë së ortakëve të Shoqërisë.

Administrator i Shoqërisë mund të emërtohet edhe një person i tretë jashtë ortakëve.

Administrator ka të drejtën e emërimit të një personi të tretë përmes një Prokure të Përgjithshme, duke u konsideruar ku veprim i lejuar sipas këtij Statutit.

## NENI 11

### Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) Kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të veprimtarisë tregtare të Shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga ortakët.
- b) Të përfaqësojë shoqërinë tregtare.
- c) Të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumentave dhe të librave kontabël të Shoqërisë.
- d) Të përgatitë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara ortakët të vetëm për miratim.
- e) Të krijojë një sistem paraljamërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë.
- f) Të kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të regjistrimit.
- g) Të raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e Shoqërisë tregtare.

Administrator është i detyruar të thërrasi mbledhjen e ortakut të vetëm edhe në rastet kur: Sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e Shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të tij, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5% të asetëve të Shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara.

Administrator ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administrator përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore SHqiptare apo të huaja, Bankave të të gjitha niveleve, zyrave të tatim taksave, autoriteteve doganore, përfshirë këtu edhe autoritetet gjyqësore të gjitha shkallëve. Administrator angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e tij.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund të injorqin këtë



akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

#### NENI 12

##### Përgjegjësitë

Administrator është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve për shkelje të statutit, apo për faj të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Ortakët që i sjellin dëm Shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për tregtarët dhe Shoqërinë Tregtare", administrator detyrohet:

1.

- a) Të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesim më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis.
- b) Të ushtrojë kompetencat që njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita.
- c) Të vlerësojë me ëporgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim.
- d) Të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit present apo të mundshëm, të interesave personal me atë të Shoqërisë.
- e) Të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizëm dhe kujdesin e nevojshëm.
- f) Administrator gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj Shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e Shoqërisë tregtare me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

2. Administratori gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj Shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e Shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. nëse administrator vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë Shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standarteve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.

4. në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë Shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregëtarët dhe Shoqërinë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:

- a) U kthen ortakëve kontributet
- b) U paguan ortakëve interesa apo dividindë
- c) U shpërndan aktivet Shoqërisë

d) Lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregatë, kur në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që Shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet

e) Jep kredi

#### **NENI 13**

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

#### **NENI 14**

Bilanci i shoqërisë dhe dividendët

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, mbledhja e asamblesë së ortakëve, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e asamblesë së ortakëve vendos rreth shpërndarjes së dividendit, pasi të jetë zbritur humbjet e vitit të mëparshëm financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

#### **NENI 15**

Ekspertët

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, ata gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve, për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

#### **NENI 16**

Të ardhurat neto (Dividenti) që mbetën pas veçimit të fondeve ligjore të mësipërme dhe të atyre për shlyerjen e çdo detyrimi fiscal apo likuidimin e pagesave ndaj të tretëve, i mbetën dhe i kalojnë në pronësi, ortakëve të shoqërisë.

#### **NENI 17**

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a) Kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelin e tij.
- b) Me vendim të Asamblesë së ortakëve.
- c) Me hapjen e procedurave të falimentimit.
- d) Nëse nuk ka kryer veprimtari tregatë për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit"
- e) Me vendim të gjykatës.

Në këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të Shoqërisë duke caktuar një apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tyre, emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".



Prishja e Shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Asambleja e Ortakëve.

Nëse Asambleja e ortakëve nuk merr vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të përcaktuar një likuidues.

#### **NENI 18**

Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij.

Nëse shoqëria emëron më shumë se një likuidues, përveçse kur akti i emërimit parashikon se ata vepronë veçmas njëri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht të drejtat e detyrimet sipas këtij ligji. Likuiduesit mund të autorizojnë njërin prej tyre të kryejë veprime të një kategorie të posaçme.

Kufizimet e tagrave të likuiduesve u kundrejtohen të tretëve, në përputhje me përcaktimet e ligjit.

Likuiduesi u nënshtrohet mbikqyrjes së ortakëve dhe administratorit.

#### **NENI 19**

Të drejtat e detyrimet e likuiduesit

1. Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të Shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të Shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.
2. Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar.
3. Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, sipas nenit 194 të ligjit "për Tregtarët dhe Shoqëria Tregatë", likuiduesit vërejnë se pasuria e Shoqërisë tregtare, përfshijrë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t'i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.

Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet në shoqërinë kolektive dhe komandite miratohen nga ortakët e tjerë, ndërsa në shoqërinë aksionare apo nga ato me përgjegjësi të kufizuar miratohen nga asambleja e përgjithshme.

#### **NENI 20**

Përfundimi i likuidimit

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Regjistrimit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon ç'rregjistrimin e shoqërisë, në përputhje me seksionin V të ligjit nr. 9723 datë 3.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

#### NENI 21

Dy ose më shumë shoqëri mund të bashkohen nëpërmjet:

1. Kalimit të të gjitha aktiveve e pasiveve të njëres ose më shumë prej shoqërive, që quhen shoqëritë e përthithura, të një shoqëri tjetër ekzistuese, e quajtur shoqëria përthithëse, në këmbim të aksioneve apo kuotave të kësaj shoqërie. Ky proces quhet bashkim me përthithje.
2. Themelimit të një shoqërie të re, tek e cila kalohen të gjitha aktivitetet e pasivitetet e shoqërive ekzistuese, që bashkohen në këmbim të aksioneve apo kuotave të shoqërisë së re. Ky proces quhet bashkim me krijim i një shoqërie të re.

#### NENI 22

Ndarja

1. Një Shoqëri mund të ndahet me vendim të asamblesë të ortakëve duke transferuar të gjitha aktivitetet e pasivitetet e veta në favor të dy ose më shumë shoqërive ekzistuese apo të themeluara rishtazi. Shoqëria që ndahet, vlerësohet e prishur.
2. Për ndarjen e shoqërisë zbatohen përkatësisht dispozitat e neneve 216 deri në 225 të ligjit 9901 datë 14.04.2008.
3. Shoqërinë, që fitojnë pasuritë e shoqërisë që ndahet, quhen shoqëri pritëse dhe përgjigjen në mënyrë solidare për detyrimet e këtij të fundit.
4. Regjistrimi i ndarjes së shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit ka si pasoje:
  - a) Kalimin të shoqërisë pritëse të të gjitha aktiveve të shoqërisë që ndahet, në përputhje me raportin e ndarjes, të përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes. Ky kalim sjell pasoja për marrëdhëniet ndërmjet shoqërive, si dhe për palët e treta.
  - b) Bërjen e aksionarëve/ortakëve të shoqërisë që ndahet aksionarë apo ortakë të një ose më shumë shoqërive pritëse, në përputhje me raportin e ndarjes, përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes.
  - c) Vlerësimin e shoqërisë që ndahet si e prishur dhe ç'rregjistrimin e tij nga Qendra Kombëtare e regjistrimit sipas seksionit V të ligjit nr. 9723, datë 3.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" pa kryerjen e likuidimit.

#### NENI 23

Shndërrimi

Shoqëria mund ta ndryshojë formën e vet ligjore, nëpërmjet shndërrimit të tij në shoqëri aksionare.

Shndërrimi nuk sjell pasoja mbi të drejtat e detyrimit, që shoqëria ka marrë përsipër ndaj të tretëve.

#### NENI 24

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në republikën e Shqipërisë.



**NENI 25**

Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statute si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetentë Gjykatë Shqiptare.

**NENI 26**

Dispozita Përfundimtare

Autorizohet Z. Maksim Sallabanda, të depozitojë këtë akt themelimi dhe statut të Shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe të ndjekë të gjitha procedurat ligjore për regjistrimin e saj si person juridik.

Ky Akt Themelimi dhe Statut i Shoqërisë "BASALT PRIME" shpk, u redaktua nga "Ortakët Themelues" në 4 ekzemplarë me vlera të njëjta juridike në gjuhën shqipe me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike.

**ORTAKË THEMELUES TE SHOQERISE  
"BASALT PRIME" shpk**

**MAKSIM SALLABANDA**

*Maksim Sallabanda*



**ZANA GRAMSHI**

*Zana Gramshi*

